

RENDI I DITËS

**Shorti “Për caktimin e relatorit të kërkesës ankimore nr. 8. Subjekti ankues,
zoti Arqilea Bollano, kryetar i komanduar i Bashkisë Himarë, me objekt:
“Shfuqizimi i vendimit nr. 159, dt.1.08.2024 të KSHZ”.**

PJESËMARRJA :


- **Stafi KQZ: Znj. M. Çelmeta, Z. E. Mema.**

Znj. M. Çelmeta: Përshëndetje! Sot në datën 2 gusht 2024, do të zhvillohet procedura e hedhjes së shortit për përcaktimin e relatorit për kërkesën ankimore nr. 8, të KSHZ. Subjekti ankues: zoti Arqilea Bollano, kryetar i komanduar i Bashkisë Himarë me objekt: “Shfuqizimi i vendimit nr. 159, dt.1.08.2024 “Për dhënie autorizimi për ndërrimin e venndodhjes së QV nr. 4589/00, për zgjedhjet e pjesshme për kryetar të Bashkisë Himarë, të datës 4 gusht 2024”, të KSHZ”. Procedura e hedhjes së shortit është e parashikuar në nenin 14 të rregullores së KAS-it. Për këtë kemi përgatitur 5 shirita letre, ku në një të prej tyre është shënuar Kërkesa Ankimore nr. 8 dhe katër shiritat e tjerë janë të bardhë dhe pa shënime, të cilat do të futen në pesë gogla me peshë, ngjyrë dhe formë të njëjtë nga një përfaqësues i administratës. Të pesë shiritat do të futen në gogla dhe më pas në një enë transparente. Duke qenë se anëtarët e KAS-it nuk janë të pranishëm, kanë autorizuar një përfaqësues nga KQZ që do të tërheqë goglat, në emër dhe për llogari të tyre, për përcaktimin e relatorit. Ndërkohë vijojmë me futjen e pesë shiritave të letrës në gogla. Pasi përziejmë goglat, vazhdojmë me rendin alfabetik ngjitës, duke filluar nga:

Zoti Elvin Lako: – Fleta është e bardhë dhe pa shënim.

Vazhdojmë me:

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 02.08.2024*

Zotin Elvis Çefa: – Kërkesa ankimore nr. 8.

Vazhdojmë me:

Zotin Ilirjan Rusmali: – Fleta është e bardhë dhe pa shënim.

Vazhdojmë me:

Zotin Koli Bele: – Fleta është e bardhë dhe pa shënim.

Vazhdojmë me:

Zotin Ledio Braho: – Fleta është e bardhë dhe pa shënim.

Në përfundim të procedurës së shortit për kërkesën ankimore nr. 8, relator është zoti
Elvis Çefa.

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*

